



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Financave , Punës dhe Transfereve
Ministarstvo Financija, Rada i Transfera
Ministry of Finance, Labor and Transfers

Nr. 0603123
Data 23.02.2023

Inspektorati i Punës / Inspektorata Rada/ Labour Inspectorate

01Nr.21-24

Datë:23.02.2023

Inspektori i Punës, Asllan Hajdini, ID 1297 në MFPT i autorizuar me dispozitën e nenit dhe 82 dhe 94 të Ligjit të Punës Nr. 03-L/212, dispozitën e nenit 1,2 dhe 5 të Ligjit Nr. 2002/9 dhe Ligjit Nr 03/L-017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë, dhe dispozitës së nenit Nenit 53 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe Aktgjykimi, Nr.ref: AGJ 2098/22 i datës 16. 12.2022 Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, lidhur me ankesën e parqitur nga Radiotelevizioni i Kosovës (RTK), Nr.0216/23 e dt.26.01.2023 kundër Vendimit 01Nr.21-253/8 të datës 12.01.2023 të IP-së në Prishtinë lidhur me Vendimit 01Nr.21-253/172 të datës 27.06.2022 nga Radiotelevizioni i Kosovës (RTK) në Prishtinë, IP me datën 23.02.2023, nxjerr këtë:

VENDIM

I.Ankesa me Nr.0216/23, e datës 26.01.2023 dorëzuar në emailin e Inspektoratit të punës me datë 26.01.2023, nga Radiotelevizioni i Kosovës (RTK) pas shqyrtimit të saj vendoset e **bazuar**.

II.**Anulohet dhe shfuqizohet tërësisht** Vendimi 01Nr.21-253/8 i datës 12.01.2023 si dhe Vendimi 01Nr.21-253/172 i datës 27.06.2022.

ARSYETIM

Inspektoratit të Punës me datë 16.01.2023 i është drejtuar me ankesë, Nr 0216/23 Radiotelevizioni i Kosovës (RTK) ka kërkuar shqyrtimin e ankesës nga IP-së ta Apropojë ankesën e RTK-së si të bazuar në

tërsi dhe të anulohet e shfuqizohet Vendim, 01Nr.21-253/8 i dt.12.01.2023 si dhe Vendimi 01Nr.21-253/172 i dt.27.06.2022 si dhe të refuzoi si të pa bazuar ankesën e palës ankuese Arjan Sahiti rastin që ka të bëjë me ankesën e parqitur kundër Vendimit Nr.1142/22 i datës 01.04.2022 në lidhje me shkarkimin nga pozita Udhëheqës i Marketingut-RTK / Drejtoria / Marketingu / Udhëheqësia e Marketingut, kontrata e punës, Nr.1880/16 e datës 10.06.2016 e lidhur në afat të pacaktuar, dhe vendosje në pozitën e punës: Zyrtar i Arkivit në Arkivin e Adminstratës.

IP-së konform dispozitave të Nenit 79 të Ligjit,Nr03/L-212 të Punës, Nenit 53 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, Nr.ref.AGJ 2089/22 të datës 16.12.2022, vendosi të anuloj dhe shfuqizoj tërësisht Vendimin, 01Nr.21-253/8 të datës 12.01.2023 si dhe Vendimin, 01Nr.21-253/172 të datës 27.06.2022.

Pala e paknaqur sipas dispozitave të Nenit 79 të LigjitNr.03/L-212 të Punës, mund të iniconi kontest pune në Gjykatën Kompetente- Gjykatën Themelore.

Nga se sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr.ref: AGJ 2089/22 i dt.16.12.2022 për zgjidhjen e "kontesteve të punës" apo ato që burojnë nga marrëdhënia e punës, mes të punësuarit dhe punëdhënësit një kompetencë e tillë u takon qartësisht Gjykatave të rregullta.

Në bazë të rrethanave të theksuara më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim është përpiluar në kopje të mjaftueshme identike nga 1 kopje i dorëzohet palëve në procedurë, ndërsa kopjet tjera mbeten në dosjen e këtij cegani.



Udhëzim juridik: kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankesë në afat prej 8 ditësh, Inspektoratit të Punës në Kosovë , nëpërmes Inspektorit të Punës në Drenas, Objekti Zyra e Punësimit Drenas.